



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 06/01-060/01-2522/2018

Datë. 23.02.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2018, e mbajtur me datën 23.02.2018, me fillim në orën 10.00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Anton Shala .

Në mbledhje marrin pjesë 34 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Haxhi Sejdiu, z. Nik Hyseni, z. Jusuf Osmani, z. Shaban Luma, znj. Teuta Pallaska –Milla , znj. Florentina Gjergjaj, znj. Albina Sadrija, z. Muharrem Musa, z. Faton Gutaj, znj. Diana Qarkaxhija, z. Basri Komoni, , znj. Edi Puka, znj. Drita Buza - Zhaveli, z. Jeton Vorfi, z. Agon Batusha, z. Shpend Komnova , znj. Mimoza Shala , znj. Lirika Komoni , z. Krishnik Alijaj, z. Bekim Jupa , z. Halit Isufi , znj. Dafina Syla, , z. Bashkim Gashaj, z. Bekim Ermeni, z. Sadik Hoti, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Bekim Ermeni z. Anton Shala, z. Zef Komani, znj. Arjeta Gjoklaj, z. Fazli Hoxha, znj. Valentina Alijaj, z. Edmond Dushi .

Mungojnë : znj. Miranada Lushaj, znj. Hana Zeka.

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Nënkryetari i Komunës z. Ramadan Hoti, Drejtoret e Drejtorive Komunale, përfaqësues të ZKKK-së, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal, si dhe përfaqësues nga mediat e shkruara dhe elektronike dhe qytetarë të Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi: I nderuar Kryetar i Komunës z. Ardian Gjini, të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës, Drejtor të drejtorive Komunale Të nderuar përfaqësues të Mediave, të OSBE, të nderuar të pranishëm.

Sot do ta kemi mbledhjen e tertë të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, dhe kemi Mbajtur edhe një mbledhje të jashtëzakonshme, ju njoftoj se Kuvendi për këtë mbledhje i ka **35 anëtarë**, të pranishëm në këtë mbledhje janë:33, anëtarë, meqenëse kemi koriumin po fillojmë me mbledhjen .

Kryesuesi: Rendin e ditës për këtë mbledhje e keni marrë së bashku me ftesën e mbledhjes. Ashtu siç jeni informuar MAPL-ja ka kërkuar që të rishqyrtohet vendimin për themelimin e dy komisioneve aksionareve ndërmarrjeve Publike Komunale për shkak të mos përmbushjes së kriterit për barazi gjinore që do të diskutojmë në pikën të ndryshme, materialet ju kemi shpërndarë të gjithëve në tavolinat tuaja .

Andaj a ka dikush ndonjë propozim sa i përket Rendit të Ditës .

z. Agon Batusha: Ne nuk pajtohemi me këtë rend dite sepse në Mbledhjen e KPF-së është hedhur poshtë pika e 4 e rendit të ditës dhe është paraparë përsëri në këtë rend dite , andaj ne propozojmë që kjo pikë të del

në votim si e veçantë , si dhe kemi vërejte se për pikën e tretë të rendit të ditës nuk ka ardhur materiali i nevojshëm, si dhe për pikën e katër të rendit të ditës nuk ka arsyshmëri .

znj. Diana Qarkaxhija: Kërkojmë që pika e 4 të largohet nga rendi i ditës ose të hedhet në votim ashtu siç u kërkuar nga parafolësi. Ndërsa për pikën e 2 njëra ndër kërkesat tona që të jetë anëtar Drejtori i Arsimit është plotësuar sepse udhëzimi nuk ka ndryshuar, ndërsa pjesa tjetër nga shoqëria civile nuk kemi marrë ndonjë miratim konkret që ai person të jetë përfaqësues i shoqërisë Civile, si dhe kemi kërkuar që të prezantohet një raport lidhur me borxhet e deklaruara, si dhe kemi kërkuar që të kemi edhe një raport lidhur me punën e komisionit që ka punuar gati dy vite për çështjen e banimit social .

Kryesuesi: Lidhur me pikat e rendit të ditës janë procedurat e parapara sepse nuk mundemi të prezantojmë në kuvende kërkesa ad hok pa plotësimin e dokumentacioneve andaj ne do ti prezantojmë në Kuvend të gjitha kërkesat e arsyeshme dhe të kompletuara me okultacionet e nevojshme .

z. Zef Komani: Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini në Fjalimin e mbledhjes Inauguruese dhe në fjalimin në Mbledhjen Solemne për nderë të 10 vjetorit të Pavarësisë ja ka ofruar bashkëpunimin e sigurtë opozitës andaj kërkoj nga opozita që të jetë më konstruktive, KPF-ja është një trup iu kuvendit që i ndihmon Kuvendit për kryerjen e punëve sepse rendi i ditës caktohet nga Kryetari i Komunës me Kryesuesin e Kuvendit, andaj kërkoj që të hedhet në votim rendi i ditës .

Kryetari : Për këtë pikë këtu u tha se nuk ka qen dashur të jetë në rend dite ndërsa Ligji për Vetëqeverisje Lokale e cakton qartë se rendi i ditës caktohet nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit andaj kërkesa juaj cila është saktësisht, sepse i vetmi propozim që mundet me u hedh në votim është që kjo pikë me u heq nga rendi i ditës sepse rendin e ditës e kemi marrë me kohë .

Kryesuesi: Kemi propozimin e që pika e 4 e rendit të ditës të heket nga rendi i ditës , kush është: për , kundër abstenim. **Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu 16 pro që kjo pikë të heket nga rendi i ditës, 18 kundër .**

Kryesuesi: E qes Në votim Rendin e ditës sipas ftesës që e keni marrë , Kush është për këtë rend dite , kundër , abstenim. Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu : **18 pro, 16 abstenim, rendit të ditës sipas ftesë së bërë .**

Pas votimit u miratua Ky :

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 23.01.2018 dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të mbajtur me dt. 07.02.2018 .
2. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Gjakovës
3. Formimi i Komisioni për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale.
4. Propozim për revokimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr.400-49405 i dt. 25.11.2016 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Gjakovës .
5. Shqyrtimi i kërkesës së KFC “Vëllaznimi” për ndarjen e Subvencioneve.
6. Shqyrtimi i kërkesës së z. Xhevdet Morina nga Fshati Rogovë për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore .
7. Shqyrtimi i kërkesës së z. Abedin Gashi nga fshati Ujz për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore .
8. Shqyrtimi i kërkesës së znj. Faza Sadrija nga Fshati Ujz për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore.

9. Shqyrtimi i kërkesës për formimin e Komitetit Komunal për Shndërrimin e Tokës Bujqësore në Tokë jo Bujqësore .
10. Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian i Komunës së Gjakovës 2018-2022
11. Të Ndryshme

1. Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 23.01.2018 dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të mbajtur me dt. 07.02.2018 .

Kryesuesi: Për këtë pik të rendit të ditës e kemi Shqyrtimin e Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 23.01.2018 dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të mbajtur me dt.07.02.2018 , a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket këtij procesverbali .

z. Shpend Kumnova: Unë kamë një sugjerim tek shënimin i votimeve në mbledhjet e kuvendit që është e mirë dhe transparente që të shënohen me emra se kush ka votuar pro ose kundër pikave të rendit të ditës .

Kryesuesi: Do të bëjmë përpjekje , por për momentin është e pa mundshme për shkak se nuk e ke kemi votimin elektronik, dhe nuk kemi mundësi që aq shpejt e shpejtë ti shënojmë emrat e të gjithëve dhe mënyrën se si kanë votuar .

E qes në Votimi miratimin Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 23.01.2018 dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të mbajtur me dt. 07.02.2018 , **Kush është: Për, kundër, Abstenim**
Nga Anëtarët e Kuvendit të Komunës Unanimisht u miratua Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 23.01.2018 dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të mbajtur me dt. 07.02.2018 .

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Gjakovës

Kryesuesi: Për këtë pikë e kemi Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) që është një obligim ligjor themelimi i KKSB-së me çka e keni edhe propozimin e Kryetarit të Komunës me përbërjen e këtij komiteti, materialet i keni marrë me kohë , përbërja është e caktuar me Udhëzim Administrativ se kush duhet të jetë anëtar i këtij këshilli. Në Mbledhjen e KPF-së i kemi pasur disa kërkesa dhe rekomandime që janë përfshirë në Propozimin e ri me përbërjen e Plotë .
E Hapi diskutimin për këtë pik të rendit të ditës.

z. Jeton Vorfi: Në propozim Vendimin që është dërguar për themelimin e KKSB-së është e shënuar Se është një trup me përbërje të gjer të të gjitha komuniteteve dhe shoqërisë Civile, dhe përfaqësuesi i shoqërisë civile duhet të jetë i pa varur politikisht si dhe duhet të njoftohen organizatat 30 ditë më herët për përzgjedhjen e kandidatit të tyre dhe kjo nuk ka ndodhur dhe kemi edhe reagimin e organizatave, fjala është për kandidaten e propozuar nga shoqëria civile e cila është e identifikuar me anime politike .

Kryetari: Ka anëtar të Shoqërisë civile që nuk kanë anime politike që unë nuk e njoh asnjë sepse të gjithë kanë anime politike , dhe ata që janë ankuar kësaj radhe ka qenë dashtë të ankohen edhe para 4 viteve kur anëtari KKSB-së ka qenë komisionar i partisë Politike andaj ju po i përdorni standarde të dy Fishta për me i kundërshtuar këto procese, dhe po ankoheni për një anëtare që kurrë nuk ka qenë as komisionarë dhe as anëtare e as një partie politike .

z. Jeton Vorfi: Unë kërkova që të respektohet e drejta e OJQ-ve që të propozojnë kandidatin e tyre dhe kjo është ajo që ne po e kërkojmë.

Kryetari: Sikur Shoqëria Civile të kishte një organizim të vetin një Asociacion që i përfshin të gjitha organizatat e Shoqërisë Civile do të ishte e drejtë e tyre por kjo nuk ekziston , dhe as një reagim nuk ka ardhur në zyrën time nga askush.

z. Edmond Dushi: Duke qenë se në këtë propozim janë 26 emra dhe janë edhe përfaqësuesit fetar , dhe duke pasur parasysh se në bashkësia e tarikateve nuk bënë pjesë tarikati bektashinjëve, propozoj që të jetë edhe një anëtar nga ky tarikat si dhe do të jetë edhe numri tek .

Kryesuesi: E qes në votim Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Gjakovës sipas përbërjes së propozuar : **Kush është: Për, Kundër, Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **u votua kështu: 21 pro, 5 kundër dhe 7 abstenim,** pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Gjakovës (KKSB), në këtë përbërje:

1. Ardian Gjini, kryesues i KKSB-së
2. Kristë Gjokaj, anëtar - Komandant i Stacioni të Policisë në Gjakovë
3. Ahmet Hoxha, anëtar - përfaqësues i Bashkësisë Islame
4. Ndue Kajtazi, anëtar - përfaqësues i Kishës Katolike
5. Jeton Sokoli, anëtar - përfaqësues i Bashkësisë Ungjillore
6. Nesemi Dervishdana, anëtar - përfaqësues i Tarikatit - Teqeve
7. Ifete Jakupi, anëtare - përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak
8. Elvana Qorri, anëtare - Kryesuese e Komitetit për Komunitete
9. Lumnije Shllaku, anëtare - Zyrtare për Barazi Gjinore
10. Bernard Frrokaj, anëtar - Drejtor i Drejtorisë për Arsim
11. Isak Demiri, anëtar - përfaqësues i FSK-së
12. Delvina Dobruna, anëtare - përfaqësuese e shëndetësisë
13. Bedri Cahani, anëtar - kryesues i ekipit veprues për siguri në bashkësi
14. Luan Dinaj, anëtar - përfaqësues i sektorit të emergjencave civile komunale
15. Mark Frrokaj, anëtar - Kryetar i Këshillit të prindërve të nxënësve
16. Pranvera Kershii, anëtare - përfaqësuese e ZKKK-së
17. Brilanda Ballata, anëtare përfaqësuese e personave me aftësi të kufizuar
18. Blerta Qela, anëtare - përfaqësuese për media
19. Eranda Kumnova - Baçi, anëtare - përfaqësuese e OJQ-ve
20. Dukagjin Vesvesja, anëtar - përfaqësues i Komunitetit të Biznesit
21. Agron Shala, anëtar - përfaqësues për Rogovë
22. Lendrit Qeli, anëtar - përfaqësues i komunitetit Egjiptian
23. Emrah Cermjani, anëtar - përfaqësues i komunitetit Rom
24. Krenare Bellacerka, anëtare - përfaqësuese e komunitetit Ashkali
25. Diana Sofra, anëtare - përfaqësuese për Lagjen Kolonia
26. Ilir Ukshini, anëtar - përfaqësues për Cërmjan.

2. Në rast të mungesës së Kryesuesit të KKSB-së në ndonjë takim punë, takimin e kryeson Nënkryetari i Komunës, z. Ramadan Hoti.

3. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi, më përfaqësim të gjerë nga të gjitha komunitetet dhe shoqëria civile të Komunës së Gjakovës, ndërsa anëtarët e këtij këshilli kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KKSB-së, organizimi i mbledhjeve, vendimmarrja, zëvendësimi i ndonjë anëtari, kompensimi, si dhe mbikëqyrja e punës së KKSB-së, janë të rregulluara me Udhëzimin Administrativ nr. 27./2012 MPB – 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

5. Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi paraprak , për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi .

6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .

3.Pika e tretë e rendit të ditës: Formimi i Komisioni për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Formimi i Komisioni për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, themelimi i këtij komision është i rregulluar me Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale ku 3 anëtar janë nga Ekzekutivi i Komunës 3 anëtar nga Kuvendi i Komunës Dhe 1 nga Shoqëria Civile. Ne jemi pajtuar që anëtarët e Kuvendi për këtë komision të jenë nga LDK, nga PSHDK, si dhe nga VV, dhe kërkoj që të paraqitni propozimet e juaja, dhe kërkoj që të respektohet kriteri i gjinisë sepse vendimet po kthen nga MAPL-ja .

Znj. Besarta Lekaj: Lidhja Demokratike e Kosovës propozon z. Sadik Hoti .

Kryesuesi: Kërkojmë që të respektohet kriteri i gjinisë sepse kemi 7 anëtar dhe duhet të kemi së paku 3 femra .

Znj. Diana Qarkaxhija: Ne kërkojmë sqarime pse Alternativa nuk është përfshirë në këtë komision duke e llogaritur se kemi një përfaqësim më të madhe se të gjitha subjektet opozitare .

Kryesuesi: Sot do të themelohen dy komitete dhe komisione dhe asnjëra parti nuk do të jetë e përfshirë në dy këto dhe ju jeni paraparë që të keni anëtarin në komisionin për Shndërrimin e Tokës bujqësore në jobujqësore, dhe mundeni të keni anëtarin edhe këtu nëse pajtoheni me LDK-në që të ndërroheni në këto komisione .

z. Bekim Ermeni: Ne u konsultuam me Vetëvendosjen që ata të kenë një femër anëtare të këtij komisioni dhe ne një mashkull, dhe për përqindjen tjetër mundeni ti propozoni drejtoret dhe nuk mundeni ju me na imponua ne se kënd e propozojmë .

Kryesuesi: Drejtorët do të jenë drejtoresha për Kadastër , drejtori i Bujqësisë dhe Drejtori i Administratës , andaj vetëm drejtoresha e Kadastrës është femër dhe nevojitet dy femra nga Kuvendi.

z. Bekim Ermeni: Nuk është e obligueshme që të jenë këta drejtor mundeni që ti propozoni cilin drejtor të duani sepse në Udhëzimin administrativ nuk është cekur që të jenë të caktuar cilët drejtor të jenë pjesë.

z. Bekim Jupa: Ne si pozite jemi dakorduar me kërkesën e z. Ermeni qe te kenë përfaqësim në këto komisione edhe opozita dhe tani po tentojnë që të na i caktojnë edhe rregullat se kush nga Qeverisja duhet të jetë anëtar, andaj kërkoj që të jeni korrekt sepse ne e kemi fuqinë e votës dhe mundemi të vendosim .

znj. Diana Qarkaxhija: Me qenë se po kërkohet që të jetë nga gjinia femërore ne Propozojmë znj. Drita Buza dhe plotësohet kriteri i gjinisë në përbërjen këtij komisioni .

znj. Arijeta Gjoklaj: Në emër të PSHDK-së e propozojmë z. Zef Komoni

znj. Mimoza Shala: Unë nuk dola të bëjë propozimin por dola ta trajtoj këtë problem sepse problemi qëndron tek pa barazia Gjinore sepse është e caktuar me ligj dhe kuvendi nuk është në gjendje ti përmbahet dhe po mos të ishte e rregulluar me ligj sa femra do të ishin të përfaqësuar në këto komisione. Edhe në përbërjen e KPF-së është keqpërdorur sepse ka përfituar vetëm Alternativa, andaj kërkoj që të kemi kujdes kur kemi të bëjmë me barazinë gjinore dhe mos të ndahemi në pozitë dhe opozitë .

Kryetari: Sa i përket këtyre komisioneve unë nuk kam as një preferencë përpos që të zbatohet ligji, sa i përket çështjes së barazisë gjinore po kemi probleme, sepse po hasim në vështirësi lidhur me plotësimin e kriterit ligjor nëpër grupet e subjekteve politike, por këtu nuk kemi të bëjmë me situatën që do të kemi luftë në mes të anëtarëve të këtyre komisioneve dhe është e logjikshme se duhet që pozita të kemi shumicën sepse kjo është e logjikshme, andaj kërkoj që të kemi mirëkuptim dhe të gjinden zgjidhje.

z. Kreshnik Alijaj: Lëvizja Vet vendosje e propozon znj. Mimoza Shala

Kryesuesi: kemi tri propozime znj. Drita Buza nga alternativa , z. Zef Komani nga PSHDK, dhe znj. Mimoza Shala nga VV, ndërsa nga Kryetari i KOMunpës e kemi propozimet znj. Aferdita Lama , z. Shpat Nivokazi , dhe z. Flamur Fetahaj, ndërsa nga shorerija Civile e kemi Idriz Daci
E qes në votim sipas përbërjes së propozuar : **Kush është: Për, Kundër, Abstenim .**
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu: **27 pro, 5 kundër dhe 0 abstenim**, pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, në Komunën e Gjakovës me këtë përbërje:

1. Znj. Aferdita Lama ---- Përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës
2. Z. Flamur Fetahaj -----Përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
3. Z. Shpat Nivokazi ----- Përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
4. Z. Idriz Daci -----Përfaqësues nga Shoqëria Civile
5. Znj. Drita Buza -----Përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
6. Z. Zef Komoni -----Përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
7. Znj. Mimoza Shala-----Përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

4.Pika e katërt e rendit të ditës: Propozim për revokimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr.400-49405 i dt. 25.11.2016 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Gjakovës,

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Propozim për revokimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr.400-49405 i dt. 25.11.2016 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Gjakovës, ku për shkak të kostos së pa përballueshme të Komunës dhe borxhit të grumbulluar jemi të detyruar që ta shfuqizojmë vendimin për mbulimin e shpenzimit të varrimit për të gjithë qytetarët e komunës së Gjakovës dhe të mbetet në fuqi vetëm vendimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët që janë nën asistencë sociale .

Për sqarime më të plota e ftoj Drejtorin z. Shkumbim Kastrati që ta merr fjalën

z. Shkumbim Kastrati: Kuvendi me dt. 23.09.2015 ka miratuar vendimin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës së Gjakovës që janë përfitues të skemës sociale, ndërsa me dt. 25.11.2016 kuvendi ka miratuar vendimin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët e komunës së Gjakovës në vlerë prej 180€, ndërsa problemi ka lindur se në vitin 2016 janë planifikuar për mbulimin e kësaj shume vetëm 22.500€ dhe janë paguar vetëm 99 raste që shuma totale e pagesave ka qenë 17.820€ , mirëpo kur është planifikuar buxheti në vitin 2017 për vitin 2018 nuk është bërë planifikimi dhe gjatë vitit 2017 janë grumbulluar diku 450 kërkesa në 2018 janë 68 kërkesa dhe kërkesa të vitit 2016 janë 160 raste të pa paguara që në total janë 640 kërkesa të pa paguara. Duke u nisur nga shënimet që kanë qenë në vitin 2017 për vitin 2018 ka qenë dashur që të planifikohen mjete buxhetore nga DBF me propozim të Drejtorisë për Shërbime Publike minimumi 200.000€ për këtë vit sepse mbi 100.000€ kanë qenë të grumbulluara nga viti i kaluar ndërsa duke i pasur parasysh këto probleme janë ndarë vetëm 20.000€ dhe janë 640 raste të pa kompozuar. Duke u ndodhur në këtë situatë të pa lakmueshme financiare kryetari i Komunës ka rekomanduar që të shfuqizohet ky vendim dhe të mbetet në fuqi vendimi paraprak për kokëzimin e rasteve që gëzojnë asistencën sociale i dt.23.09.2015, dhe po ju njoftoj se edhe me revokimin e këtij vendimi kemi probleme sepse i kemi 126.000€ borxh dhe nuk kemi mundësi që ta revokojmë retroaktiv këtë vendim por duhet të gjejmë një zgjidhje dhe të bëjmë këtë pagesë, Në mbledhjen e KPF-së është kërkuar që kjo shumë e borxheve të mbulohet me bartjen e mjeteve nga viti i kaluar por ne kemi një numër të kontratave të nënshkruara sidomos ato me bashkëfinancim që jemi të detyruar si komunë që të përmbushim obligimin tonë në mënyrë që mos të rrezikohen realizimi i këtyre projekteve dhe mjete e mbetura në vitin e kaluar nuk mjaftojnë as për këtë qëllim, ku vetëm për ndërresën e Komunës nevojiten 500.000€ dhe shumë obligime tjera për projektet madhore që e kalojnë 1 milion euro.

Kryetari: E falënderoj drejtorin për sqarimet e sakta por unë po ndalem vetëm tek çështjet politike sepse u tha edhe në fillim se dikush po ngreh dilema lidhur me shifrat e prezantuar si borxhe që së shpejti do të ju prezantojmë para jush, u tha edhe nga drejtori por unë do të ndalem vetëm tek një rast ku ka qenë obligim ligjor i komunës të ndërtoj rrugën deri tek vendi ku do të ndërtohet ngrohësja e re dhe janë parapa mjete 5 herë më pak sa që kushton ndërtimi i asaj rrugë, janë paraparë vetëm 600.000€ për shpronësime dhe janë 1.800.000€ obligime për shpronësim. Nuk do të ndalem pagesat për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për rastet Sociale por vetëm për kategorinë tjetër ku disa edhe nuk kanë nevojë andaj nuk është e drejtë që të bllokohen pagesat e kategorisë sociale për shkak se nuk ka Komuna mjete me i mbuluar të gjitha kërkesat .

Znj. Diana Qarkaxhija: Fillimisht kërkoj që të ndahen kategoria e Subvencioneve dhe e Projekteve sepse mjetet për projekte janë të ndara. Është shumë e dhimbshme tani të propozohet të hiqet kjo e drejtë që qytetarët e Komunës sonë e gëzojnë këtë të drejtë ashtu siç të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, po flitet se do të paguhet për kategorinë Sociale por duhet të keni parasysh se në Komunën tonë ka edhe shumë familje që jetojnë me një pagë minimale. Borxhi në këtë kategori ka mbetur për shkak të mos rishikimit të buxhetit në muajin Shtator, dhe komuna e Gjakovës ka mundësi që të bëjë këto pagesa nga kategoria Mallra dhe Shërbime, si dhe Qarkoren e brendshme nuk është nënshkruar nga Qeverisja e kaluar .

Kryesuesi: Ajo që u tha nga ju znj. Qarkaxhija se ka mjete të planifikuara është plotësisht e pa bazë sepse janë të planifikuara vetëm 20.000€ dhe nuk qëndron fakti se të gjithë anëtarët e Kuvendit e kanë përkrahur këtë vendim ashtu sikur nuk është e vërtetë se të gjitha komunat e Kosovës e kanë një vendim të tillë andaj nuk është mirë që të devijohen diskutimet këtu sepse qytetarët duhet të dinë se si qëndron puna .

z. Shkumbim Kastrati: Nuk kemi të bëjmë këtë me përzierje të kategorive dhe për qarkoren nuk po diskutohet këtu për investim kapital por lidhet me shpronësime, sepse mjetet për realizimin projektit i ka ndarë Ministria por Komuna është e obliguar që të siguroj mjetet për shpronësime. Kryetari i Komunës e ka nënshkruar një marrëveshje me Ministrin e Infrastrukturës për investime në 4 projektet kapitale , projekti i parë është Qarkorja e Gjakovës që do të investohen 8 milion euro, projekti i dytë është ndërtimi i rrugës së

Bordosanës , si dhe është nënshkruar edhe marrëveshja e rrugës Bardhaniq Dashinoc ku komuna e Gjakovës ka pasur për obligim me i paguar 90,000€ për shpronësime dhe ato tani do të paguhet nga ministria e Infrastrukturës . Rishikimi i Buxhetit nuk ka lidhje me këtë çështje sepse kjo është miratuar në Muajin Shtator për vitin 2018 dhe nuk ka lidhje me rishikim që bëhet në Qershor, pra nuk është planifikuar në këtë kategori dhe tani përballemi me këto situata .

z. Bekim Ermeni: Pikërisht këto arsye të keq prezantuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe kanë dërguar deri tek ajo se kjo pikë mos të kalojë , dhe ju po flisni për shifra të larta dhe për projekte ndërsa këtu sot kemi tjetër pikë të rendit të ditës andaj kërkoj që mos të përzihen gjërat, sepse kjo ka ndodhur për një mos planifikim të mirë dhe tani po kemi këso probleme që ne duhet të gjejmë një zgjidhje. Lidhja Demokratike e Kosovës është kundër revokimit të këtij vendimi dhe kërkojmë që të mbetet në fuqi vendimi i mandatit të kaluar .

Znj. Florentina Gjergjaj: Nuk mjafton vetëm të jesh i ndjeshëm ndaj qytetarëve por duhet edhe të planifikohet dhe të realizohen obligimet, sepse me miratimin e vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit vetëm sa i keni mushtuar qytetarët sepse nuk keni ndarë mjete në buxhet ku i keni lënë 200.000€ borxh dhe i keni ndarë vetëm 20.000€ kjo me as një logjikë nuk mundet me u barazua, dhe kjo është edhe një dëshmi për kualitetin dhe profesionalizmin e qeverisjes së Kaluar .

z. Shpend Kumnova: Nga ajo që u diskutua këtu u kumtua se Komuna i ka borxh rreth 200.000€ për këtë kategori, andaj do të ishte mirë që ky borxh të jetë i ndarë në dy pjesë, pjesa e rasteve sociale dhe pjesa tjetër që nuk janë nën asistencë sociale, sepse do të kemi më të qartë se sa janë raste sociale dhe sa jo.

z. Zef Komani: Sa i përket asaj që u tha nga z. Batusha unë më së paku kam dëshirë që të jem në komisione edhe pse kamë provojë dhe mundësi me kontribuar në këto komisione, sa i përket kësaj pike mendoj se ne duhet të veprojmë si përfaqësues të qytetarëve këtu po kërkohet që të ndryshohet një vendim i gabuar sepse Komuna e Gjakovës nuk kemi mundësi me i mbuluar të gjitha shpenzimet e varrimit, sepse ne e dimë se sa është numri i vdekshmërisë në komunë , andaj unë nuk dua ta akuzoj as qeverisjen e kaluar por sa i përket aspektit human ku deri në 25% kemi raste sociale dhe është tragjedi që Komuna nuk arrin me i kompensua këtë kategori që më të vërtet kanë nevojë për shkak të kërkesave të shumta të kategorisë tjetër që disa edhe nuk kanë nevojë, andaj kërkojmë të mbetet në fuqi vetëm vendimi për shpenzimin e kategorisë sociale .

znj. Dafina Sylja: Në mandatin e kaluar njëri ndër ata që e kemi votuar pro këtij vendimi kamë qenë edhe unë dhe ne kemi për detyrë që të nxjerrim vendim në të mirë të qytetarëve dhe jo edhe ti ekzekutojmë ato vendime sepse përgjegjëse është ekzekutivi për zbatim e këtyre vendimeve, mirëpo ky vendim në ekzekutiv nuk është zbatuar si duhet dhe nuk janë paraparë mjetet për zbatimin e ti kështu që kemi arritur deri te kjo gjendje të vështirë financiare .

znj. Edi Puka: Fillimisht kamë një këshill për z. Bekim dhe znj. Florentina që duhet të kemi kujdes për fjalorin sepse jemi të zgjedhurit e qytetarëve . Sa i përket kësaj pike këto mjete janë ndarë nga vet drejtori z. Kastrati dhe jo nga dr. Basri Komoni, gjithashtu kemi shumë raste që nuk kanë asistencë sociale dhe kanë gjendje të vështirë ekonomike dhe financiare .

Kryetari: Buxheti i vitit 2018 është miratuar në mandatin e kaluar në muajin Shtator dhe propozimin për këtë buxhet e ka bërë qeverisja e kaluar dhe nuk është buxhetuar vendimi që vet ajo qeverisje e ka miratuar dhe nuk është rasti i vetëm por kemi dhjetëra projekte që vet janë nënshkruar dhe nuk janë ndarë mjetet .

z. Agon Batusha: Secili anëtar i Kuvendit ka të drejtë me e marrë fjalën 10 minuta dhe duhet që të respektohet secili në fjalimin e ti . Sa i përket këtij vendimi në mandatin e kaluar është propozuar nga një anëtar i kuvendit dhe ish kryesuesi nuk i ka ndjekur proceduar sepse është bërë kërkesa dhe nuk është

proceduar në KPF, Buxheti në Kuvend vije pa pasur mundësi që kuvendi të ndryshoj vije nga qeverisja. Nëse ne sot miratojmë këtë revokim të vendimi po i bje se kuvendi po bën lojna dhe ne si VV nuk pajtohemi që ky vendi të revokohet dhe do të votojmë kundër .

z. Fazli Hoxha: Kjo pikë është shumë e ndjeshme për qytetarët e Komunës së Gjakovës parimisht jemi kundër revokimit të këtij vendimi por duke pasur parasysh rrethanat në të cilat ndodhet komuna për shkak të mos planifikimit të mjeteve për zbatimin e këtij vendimi jam që të gjendet një zgjidhje dhe sot do të votojmë për revokimin e ti por në të ardhmen do të insistojmë që ky vendim të kthehet në fuqi.

Kryesuesi: Pasi që nuk ka më diskutime E qes në votim Propozim për revokimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr.400-49405 i dt.25.11.2016 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Gjakovës, dhe të Mbetet në fuqi vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr. 011-67966 i dt.23.09.2015 , për mbulimin e shpenzimeve të varrimit në vlerë prej 200 € për qytetarët e Komunës së Gjakovës, që janë përfitues të skemës Sociale **Kush është: Për, Kundër, Abstenim .** Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua Kështu : **18 pro, 14 kundër 1 abstenim .** pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Revokohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr.400-49405 të dt. 25.11.2016, për mbulimin e Shpenzimeve të Varrimit për të gjithë Qytetarët e Komunës së Gjakovës .
2. Mbetet në fuqi vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr. 011-67966 i dt.23.09.2015 , për mbulimin e shpenzimeve të varrimit në vlerë prej 200 € për qytetarët e Komunës së Gjakovës, që janë përfitues të skemës Sociale .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

5. Pika e pestë e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së KFC “Vëllaznimi” për ndarjen e Subvencioneve.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën e KFC “Vëllaznimi” për ndarjen e Subvencioneve, për vitin 20018 me çka rregullorja Komunale për Ndarjen e Subvencioneve e parasheh që për vlerat më të larta se 15.000€ vendimin duhet të kaloj në Kuvendin e Komunës, kjo pikë është diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe është kërkuar që ti bashkëngjitet edhe kërkesa e DKRS-së dhe ju kemi dërguar me materialin e mbledhjes, prezent e kemi edhe Drejtoreshën e DKRS-së znj. Saranda Hyseni të cilën e ftoj që ta merr fjalën .

znj. Saranda Hyseni; DKRS-së ka pranuar një kërkesë nga KFC Vllaznimi për subvencionimin e këtij klubi i cili gjendet në një gjendej para kolapsit, mënyra e ndarjes së subvencioneve është e rregulluar me Rregulloren Komunale dhe deri në shumën 15,000€ nuk ka nevojë të dërgohet në Kuvend por këtu kemi të bëjmë me një shumë më të lartë që bëhet fjalë me shumën 45.000€ , andaj e kemi dërguar sot para jush . Këto mjetet do të merren nga buxheti i DKRS-së kjo është shumë e madhe për Buxhetin e DKRS-së mirëpo duke e pasur parasysh gjendjen e këtij klubi jemi detyruar që ti bëjmë një zgjidhje dhe pastaj do të mundohemi që me rishikim të Buxhetit të rritet shuma në këtë drejtori sepse do të kemi shumë vështirë me këto mjete të mbulohen komplet nevojat e kësaj drejtorie .

E hapi diskutimin për këtë pikë .

Znj. Mimoza Shala: Kjo shumë është shumë e lartë në vlerë prej 45.000€ dhe sa herë që ky klub po hyj në obligime po detyrohem në si Komunë që të merremi me këtë problem, andaj a ka ndonjë zgjidhje që pasi t'ndahen këto mjete ku klub të funksionoj dhe mos të jemi të obliguar që të vazhdojmë në këtë situatë edhe në të ardhmen.

z. Shpend Kumnova: Këtë kërkesë do të përkrahim por kërkoj që në një të ardhmë të kemi një strategji të përkrahjes sepse duhet e përkrahim një klub ose një sport po i diskriminojmë klubet ose sportet tjera andaj duhet të gjendet një zgjidhje për mes sektorit privat dhe do të ishte zgjidhja më e mirë .

Kryetari: Në këtë situatë jemi të detyruar të intervenojmë sepse ku klub është në një gjendje të rëndë dhe në të ardhmen qëllimi imë është që ky klub të shndërrohet në shoqëri aksionare dhe kjo është dakorduar edhe me shumë personalitet që kanë kontribuar me vite dhe të kryetarit të Klubit, dhe do të veprojmë në këtë drejtim dhe do të kemi lajme të mira por tani duhet të intervenojmë që të vazhdoj ku klub.

Kryesuesi: E qes në votim kërkesën për ndarjen e 45,000€ KFC “Vëllaznimi”, **Kush është për Kundër Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro** këtij vendimi, pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për mbështetje financiare për Klubin e Futbollit KFC “Vëllaznimi” nga Gjakova, në vlerë prej 45,000.00€ .
 2. Mjetet financiare në vlerë prej 45,000.00€ do të derdhen në xhirollogarinë e Klubit Futbollistik KFC “Vëllaznimi”, nga fondi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport .
 3. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të shpenzohen nga KFC “Vëllaznimi” me qëllim që ky klub ti mbulojë shpenzimet që rrjedhin nga obligimet nga fushë veprimtaria e tij .
 4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
- 6. Pika e gjashtë e rendit të ditës :** Shqyrtimi i kërkesës së z. Xhevdet Morina nga Fshati Rogovë për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore .

Kryesuesi : Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i kërkesës së z. Xhevdet Morina nga Fshati Rogovë për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore, kërkesë kjo e cila ka kaluar nëpër procedurat e nevojshme dhe është dërguar për shqyrtim në KPF, andaj e ftoj Drejtorin e Drejtorisë Për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural z. Shpat Nivokazi që ta marrë fjalën .

z. Shpat Nivokazi : Drejtoria Për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim rural ka pranuar kërkesën për Shndërrimin e Tokës Bujqësore në jobujqësore nga z. Xhevdet Morina nga Fshati Rugovë parçela është në sipërfaqe prej 1000m² në ngastrën nr.793 me kulturë arë e klasës së 4 , dhe në bazë të Udhëzimit administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës nga bujqësore në jo bujqësore vendimin për shndërrimin e tokës duhet të bëhet nga Kuvendi pas marrjes së Pëlqimit nga MBPZHR, pala ka marrë këtë pëlqim dhe i ka plotësuar të gjitha dokumentacionet e kërkuara dhe kërkohet që të nxjerë4rim edhe këtë vendim.

Kryesuesi: E hap diskutimin për këtë pikë

Kryesuesi: E qes në votim, kërkesën e z. Xhevdet Morina nga Fshati Rogovë për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore . kush është: Për, kundër, Abstenim.
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro** . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë :

V e n d i m
Për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë jo bujqësore

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë jo bujqësore, tokë e klasës së -IV- (katërt), me kulturë arë, në pronësi të pronarit z. Xhevdet Morina nga Fshati Rogovë, në parcelën nr.P 70713071-00793-0 Zona Kadastrale Rogovë me sipërfaqe prej 1000 m².
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

7. Pika e shtatë e rendit të Ditës : Shqyrtimi i kërkesës së z. Abedin Gashi nga fshati Ujz për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore .

Kryesuesi: Edhe kjo kërkesë ka të bëjë me Shndërrimin e tokës Bujqësore në Jo bujqësore është diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së, e ftoj Drejtorin e Drejtorisë Për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural z. Shpat Nivokazi që ta merr fjalën, dhe të na sqaroj procedurat dhe arsyeshmërin e kësaj kërkesë .

z. Shpat Nivokazi : Edhe kjo kërkesë është e natyrës së njëjtë si pika paraprake dhe ka kërkuar shndërrimin me qëllim të ndërtimit të Stallës për majmëri dhe objekteve përcjellëse , kjo kërkesë ka të bëjë me tokë e klasës së -IV- (katërt) me kulturë Pyll, me sipërfaqe prej 1000 m², në pronësi të pronarit z. Abedin Gashi nga Fshati Ujz, në parcelën nr. P70713080-00505-3 Zona Kadastrale . UJZ

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë .

Kryesuesi: E qes në votim, kërkesën e z. Abedin Gashi nga Fshati Ujz, për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore . kush është: Për, kundër, Abstenim.
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro** . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë :

V e n d i m
Për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë jo bujqësore

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë jo bujqësore, tokë e klasës së -IV- (katërt) me kulturë Pyll, me sipërfaqe prej 1000 m², në pronësi të pronarit z. Abedin Gashi nga Fshati Ujz, në parcelën nr. P70713080-00505-3 Zona Kadastrale . UJZ.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

8 Pika e tetë e rendit të Ditës: Shqyrtimi i kërkesës së znj. Faza Sadrija nga Fshati Ujz për shndërrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore.

Kryesuesi: Edhe kjo kërkesë sikurse dy pikat paraprake ka të bëjë me Shndërrimin e tokës Bujqësore në Jo bujqësore andaj e ftoj Drejtorin e Drejtorisë Për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural z. Shpat Nivokazi që ta marr fjalën, dhe të na sqaroj procedurat dhe arsyeshmërinë e kësaj kërkesë .

z. Shpat Nivokazi : Kjo kërkesë është nga znj. Faza Sadrija nga fshati Ujzë kërkesa ka të bëjë me qëllim të ndërtimit të objektit Stallë për majmëri të gjedheve dhe objekteve përcjellëse. Kërkesa ka të bëjë për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë jo bujqësore, tokë e klasës së -IV- (katërt) me kulturë arë, me sipërfaqe prej 1100 m², në pronësi të pronarit znj. Faza Sadrija nga Fshati Ujzë, në parcelën nr. P70713080-00494-3 Zona Kadastrale UJZ.

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë .

Kryesuesi: E qes në votim, kërkesën e znj. Faza Sadrija nga Fshati Ujz, për shndërrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore . kush është: Për, kundër, Abstenim.

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro** . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë :

V e n d i m

Për shndërrimin e tokës Bujqësore në tokë jo bujqësore

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë jo bujqësore, tokë e klasës së -IV- (katërt) me kulturë arë, me sipërfaqe prej 1100 m², në pronësi të pronarit znj. Faza Sadrija nga Fshati Ujz, në parcelën nr. P70713080-00494-3 Zona Kadastrale UJZ.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

9. Pika e Nëntë e rendit të ditës : Shqyrtimi i kërkesës për formimin e Komitetit Komunal për Shndërrimin e Tokës Bujqësore në Tokë jo Bujqësore

Kryesuesi: Kjo kërkesë është për formimin e Komitetit Komunal për Shndërrimin e Tokës Bujqësore në Tokë jo Bujqësore , kjo është një domosdoshmëri sepse Kuvendi mbledhet një herë në muaj dhe këto kërkesa janë të afatëshme që mundet të shkaktoj deri tek humbja e grandeve dhe projekteve ose donacioneve të ndryshme, andaj Kuvendi ka mundësi që këtë kompetencë ta bartë në Komitetin e vete dhe ka qenë edhe në mandatin e kaluar .

Andaj tani kërkojmë që subjektet politike që u dakorduar në formimin e komisionit tjetër, kërkoj kandidatin nga LDK-ja

z. Bekim Ermeni: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës-ja e propozojmë znj. Besarta Lekaj .

z. Fazli Hoxha: Nisma Socialdemokrate e propozon znj. Valentina Alijaj .

z. Bekim Jupa : Partia Demokratike e Kosovës propozon z, Bashkim Gashaj

z. Muharrem Musa: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e propozon z. Nik Hiseni

Kryesuesi: Meqenëse jemi pajtuar që të jetë e përfshirë edhe AKR , e propozoj z. Edmoind Dushi

Kryesuesi: E qes në votim, Themelimin e Komitetit për shndrimin e tokës Bujqësore në tokë Jo bujqësore, sipas përbërjes së prezantuar. kush është: Për, kundër, Abstenim.
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **u Votua kështu : 27 pro, 1 Kundër dhe 0 abstenim.** Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti Komunal për shndërrimin e tokës bujqësore në jo bujqësore në Komunën e Gjakovës, me këtë përbërje:

1. z. Nik Hiseni
2. znj. Valentina Alijaj
3. z. Bashkim Gashaj
4. znj. Besarta Lekaj
5. z. Edmond Dushi

2. Ky Komitet është kompetent për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me shndërrimin e tokës bujqësore në jo bujqësore .

3. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, do të asistoj me ndihmë profesionale në punën e këtij Komiteti .

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës: Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian i Komunës së Gjakovës 2018-2022

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi shqyrtimin e Planit Lokal i Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian i Komunës së Gjakovës 2018-2022, andaj e ftoj Përfaqësuesin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim z. Armend Behluli që të merr fjalën .

z. Armend Behluli: Ky plan është në vazhdimësi e Planit 2012-2015, ku Qeveria e Kosovës e ka hartuar një strategji që thirret Strategia Kombëtare për përfshirjen e komuniteteve, dhe në kuadër të këtij plani ne si Komunë e Gjakovës e kemi hartuar këtë plan për përfshirjen e komuniteteve dhe procesi i hartimit të këtij plani i ka kaluar disa faza që janë të parapara sipas ligjeve është bërë diskutimi publik dhe janë kryer të gjitha procedurat , në kuadër të këtij plani janë 4 fusha , që janë ; fusha e arsimit , punësimi dhe mirëqenia sociale shëndetësia dhe banimi. Sa i përket koston për implementimin e këtij plani edhe në vitet e kaluara shumica e aktiviteteve të parapara mbulohen nga institucionet qendrore sepse është në kuadër të strategjisë kombëtare të integrimit të Komuniteteve RAE .

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi: E qes në votim, Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian i Komunës së Gjakovës 2018-2022.. kush është: Për, kundër, Abstenim.

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro** . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian i Komunës së Gjakovës 2018-2022 .
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian i Komunës së Gjakovës 2018-2022 .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Kryesuesi: Kërkoj 10 minuta pauzë sepse kryetari i komunës ka një takim dhe duhet që të jetë prezent në vazhdimin e kësaj mbledhje kështu që për 10 minuta do të na bashkohet

11.Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës : Të ndryshme

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për rishqyrtimin e vendimit për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për ndërmarrjen Publike Komunale KRM Çabrati, për arsye se tre anëtarët kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe kërkohet që të plotësohet kriteri i Gjinisë, andaj Kryetari i Komunës ka miratuar vendimin dhe e ka zëvendësuar z. Afrim Derivishi me znj. Aferdita Lama, kështu që plotësohet kriteri i kërkuar nga MAPL, dhe nga Kuvendi kërkohet që në Harmoni me rekomandimin e MAPL-së të bëjmë harmonizimin e vendimit të Kuvendit nr. 112/2-1383 të dt. 23.02.2018 ashtu që në vend të z. Afrim Dervishi, anëtari emërtuar nga Kryetari në Komisionin Komunal të Aksionareve emërtohet znj. Aferdita Lama dhe përbërja e Plotë është : Znj. Aferdita Lama , Z. Bekim Jupa, Z. Kreshnik Alijaj.

Kryesuesi: E qes në votim, miratimin e kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për rishqyrtimin e vendimit për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për ndërmarrjen Publike Komunale KRM Çabrati sipas kësaj përbërje, kush është Për , Kundër , Abstenim .

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro** . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale, KRM “Çabrati” në Gjakovë, në këtë përbërje:

1. znj. Aferdita Lama, e emëruar nga Kryetari i Komunës.
2. z. Bekim Jupa, përfaqësues i Kuvendit.
3. z. Kreshnik Alijaj, përfaqësues i Kuvendit.

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Kryesuesi: Edhe për këtë pikë e kemi kërkesën e njëjtë nga MAPL-ja që për shkak të kriterit të Barazisë gjinore është kërkuar që të rishikohet vendimi i Kuvendit të komunës për themelimin e komisionit komunal

të aksionarëve për ndërmarrjen Publike komunal e **Ngrohtorja e Qytetit** , dhe nevojitet që njëri nga tre anëtarët e këtij komisioni të jetë nga gjinia femërore

andaj kemi kërkesën që të bëhet ky zëvendësim anëtarët e këtij komisioni janë: 1. Dukagjin Vesvesja i emëruar nga Kryetari, 2. z. Zef Komani dhe 3 . z. Bashkim Gashaj , andaj kërkojmë nga PDK që të bëjë zëvendësimin me një anëtarë të gjinisë Femërore në vend të z. Bashkim Gashaj .

z. Bekim Jupa : Partia Demokratike e Kosovës propozon që të zëvendësohet z. Bashkim Gashaj me znj. Dafina Syla

Kryesuesi: E qes në votim, miratimin e kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për rishqyrtimin e vendimit për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për ndërmarrjen Publike Komunale **Ngrohtorja e Qytetit**, sipas kësaj përbërje, **kush është për , Kundër , Abstenim**
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro** . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale, “Ngrohtorja e Qytetit “ në Gjakovë, në këtë përbërje:

1. z. Dukagjin Vesvesja , i emëruar nga Kryetari i Komunës.
2. z. Zef Komoni, përfaqësues i Kuvendit .
3. znj. Dafina Syla, përfaqësuese e Kuvendit .

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Kryesuesi: Nga Subjekti politik Alternative kemi një kërkesë që e ftoj z. Jeton Vorfi ta merr fjalën

z. Jeton Vorfi: Në fillim të mbledhjes ne kemi kërkuar që anëtari i Alternativës në Stacionin e Autobusëve të ndërrohet me atë në Ngrohtoren e qytetit sepse propozimi ynë ka qenë znj. Hana Zeka e cila është me profesion ekologe dhe e diplomuar pikërisht në Biomassë që do të kishte mundësi me dhënë kontribut më të madhe në këtë ndërmarrje, si dhe jemi partia më e madhe opozitare dhe na takon të kemi këtë vend kjo është kërkesa për PSHDK-në .

Kryesuesi: Ju keni kërkuar që në vend të z. Jeton Vorfi anëtar i komisionit te Stacioni i Autobusëve të jetë z. Basri Komoni .

z. Jeton Vorfi : Nëse nuk është e mundur që të bëhet ky ndryshim atëherë ne propozojmë që në vend timin tek Komisioni Komunal i Aksionareve të jetë z. Basri Komoni .

Kryesuesi: E qes në votim, miratimin e kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të aksionarëve për NPK Stacioni i autobusëve ashtu që në vend të z. Jeton Vorfi të jetë z. Basri Komoni, pjesa tjetër e vendimi të mbetet në fuqi, **kush është për , Kundër , Abstenim**.

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro** . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë

V E N D I M

1. Ndryshohet përbërja e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale “Stacioni i Autobusëve” në Gjakovë, ashtu që në vend të z. Jeton Vorfi , anëtar i ri i këtij komisioni është z. Basri Komoni :
2. Pjesa e tjetër e vendimit 01 nr.112/02-1384 i dt. 23.01.2018 mbetet në fuqi .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Kryetari: Dua të ju njoftoj se i kemi iniciuar procedurat për themelimin e Komitetit Komunal për Arsim, këshillit publiko privat , dhe të grupit punues për Planifikim Afatgjatë për planifikim dhe për mbeturina, këto trupa nuk janë obligative por për të krijuar kohezion brenda shoqërisë dhe Komunës, tek këshilli publiko provat ideja është që të mblidhen të gjithë ata që kontribuojnë të jetë një trup permanente konsultative në mënyrë që të kemi biznes sa më shumë në Komunën e Gjakovës, komuna të kontribuoj që të zhvillohen bizneset, këto trupa nuk mundën të nxjerrin vendime por nxjerrin rekomandime dhe këshilla për planet dhe projektet e zhvillimit ekonomik të komunës andaj kërkoj nga të gjithë që të ndikoni që sa më shumë biznese të kyqen në këtë këshill.

Këshilli Komunal për Arsim , është jetike që ne si Komunë të bëjmë diçka ashtu që veprimet tona mos të ndryshojnë sa herë që ndryshon administrata Komunale andaj kërkoj nga opozita por edhe me pozitën që të punojmë para se të miratohen vendimet dhe të kryqen njerëzit më të mirë që kanë dhënë për arsimin ti dërgoni propozimet e juaja në zyrën e Kryesuesit ose në zyrën time sepse qëllimi është që të kemi kontinentet dhe të fillohet me ndërtimin e këtyre programe afatgjata .

Aspekti mjedisor dhe i mbeturinave , ene kemi filluar me një projekte afatshkurtër në mënyrë që të krijohet një ndjenjë se mundemi të veprojmë dhe të mbajë të pastër ambientin në dy vende kemi pasur vështirësi sepse i kemi pastruar tërësisht zonën dhe brenda javës është kthyer prapë në gjendjen e mëparshme , mirëpo tani do të provojmë me këtë veprim dhe do të pastrojmë zonat veç e veç dhe do të veprojmë me politika afatgjata , andaj kërkoj që të kyçeni të gjithë sepse nuk kam tendencë që ti marrë meritat e të tjerëve . Këto janë njoftimet e mia dhe kërkoj që të konsultoheni dhe të bëheni pjesë e këtyre trupave sepse sa më shumë që të bashkëpunojmë aq më të suksesshëm do të jemi në këto veprime .

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë

z. Agon Batusha: Në qeverisjen e kaluar është krijuar ndjenja kinse qeverisja në Gjakovë ka filluar me këtë qeverisje, Qeverisja në Gjakovë është vazhdimësi dhe politikat afatgjata e bëjnë më të qëndrueshëm zhvillimin ekonomike dhe të gjitha sektorët në Komunën Gjakovës, andaj ne duhet të zhvillojmë politika afatgjata që të kemi një vazhdimësi, Kryetari do të ketë bashkëpunimin e lëvizjes vetëvendosje në këto politika afatgjata, dhe do të jemi pjesë aktive e këtyre proceseve . Një shqetësim që dua të ngris është objekti i ish shkollës së Muzikës Prenk Jakova që është në një gjendje të mjerueshëm, ky objekt është një monument historik që është në një gjendje të rëndë dhe kërkohet intervenim nga komuna veçanërisht nga Drejtoria e Kulturës.

Kryetari: Kjo që u tha nga z. Batusha ka të bëjë me Mejtepin Ruzhdije dhe është kryer projekti është marrë si donacion nga një organizatë Turke dhe së shpejti do të fillojnë punët do të rinovohet dhe do të duket ashtu siç ka qenë dukja fillestare dhe do të shfrytëzohet si hapësirë për OJQ që merën me Kulturë dhe trashëgimi , dhe do të jetë në pronësi të Komunës.

Znj. Mimoza Shala: E përgëzoj kryetarin për kërkesën për gjithë përfshirje në këto trupa e sidomos për formimin e komitetit për arsim sepse nëse arsimi nuk është në nivelin e duhur atëherë sigurisht se do të kemi

në të gjitha sferat ngecje . Dua ta paraqes kritikë sepse kemi marrë vërejtje nga aplikonte për punësim sepse epo përzgjedhin njerëzit që kanë ndikuar politika , njëjtë ka qenë edhe në qeverisjen e kaluar, andaj mendoj se jemi ka ndërhyje në çështjen e shenjet në arsim andaj me formimin e këtij këshilli mendoj se nuk do të ketë ndërhyrje në punësimin e arsimit .

z. Edmond Dushi: Pajtohemi me propozimin e këtyre tri këshillave siç u quajtën nga Kryetari por unë sugjeroi që kemi kujdes tek terminologjia sepse në ligjin për Vetëqeverisje Lokale janë të parapara Komitetet konsultative dhe Komitetet tjera.

Shqetësimi imë është ky para disa dite kemi pranuar një kërkesë nga disa qytetar që janë të varur nga Insolina dhe pyetja e tyre për kryetarin është se si qëndron problemi me këtë barë dhe kur do të mundemi të furnizohemi sepse është një nevojë e domosdoshëm .

Kryetari: Këto trupa nuk janë këshilla të Kuvendit por kanë një rol tjetër dhe janë këshilla konsultativ . Për çështjen e Insolinës kemi biseduar me drejtoreshën dhe kemi kërkuar edhe nga Ministria dhe ekziston ky problem ne jemi të angazhuar dhe do ti shikojmë ët gjitha mundësit që ti dalim në ndihmë këtyre qytetarëve .

Znj. Adelina Shehu Kola: Kemi bërë 3 herë kërkesë nga Ministria dhe kemi marrë përgjigjeje se nuk ka tender dhe nuk kemi kapacitet për furnizim sepse ky problem ekziston ne të gjitha komunat jo vetëm tek ne .

Kryetari: Nëse nuk do të zgjidhet shpejtë ky problem ne do të shikojmë dhe brenda mundësive të ju dalim në ndihmë .

Znj. Diana Qarkaxhia : Propozimet e kryetarit janë me vend por praqes shqetësimin e njëjtë me z. Dushi se duhet të kemi të qartë se kujt po i referohemi . Dua të ju informoj se në çdo shkollë ekziston këshilli drejtues i shkollës dhe Komuna e Gjakovës e ka edhe këshillim e prindërve . Lidhur me objektin e vjetër afër shkollës së muzikës është një projekt i nisur më herët dhe do të fillojnë punimet pasi të përfundoj projekti i konvikteve . Kam një propozim për kryetarin se në momentin kur të rinovohet ai objekt të destinohet për Shkollë të artit Figurativ sepse kemi mjaft kuadro të përgatitura . Kërkesa ime është që të kemi edhe CV e drejtorëve komunal që të kemi edhe profesionalizmin e drejtorëve sepse u fol më herët për profesionalizmin e qeverisjes së kaluar. Kemi një pyetje e të ngritur nga disa qytetar nga pjesa e vjetër e qytetit tek Ura e Taliqit se a ka leje objekti që po ndërtohet tek ura e Taliqit ku themelet e këtij objekti janë shumë afër një ure që lidh dy pjesët e qytetit si dhe është shumë afër një ure që është nën mbrojtje si monumente të trashëgimisë kulturore .

Kryetari: Unë e përnda se ky këshill do të quhet këshilli komunal për Arsim dhe nuk është organ vendimmarrës i cili do të provoj të nderohen plane afatgjata të arsimit, të ndërtohen plane si ti qasemi problemeve . Për shkollën vjetër të Muzikës , është pronë e Komunës dhe pas renovimit se për çka do të shfrytëzohet do të vendos Komuna dhe nuk do të jetë diçka që del jashtë asaj që përdoret për kulturë dhe art. Lidhur me objektin tek Ura e Taliqit nuk e di se a ka leje por do të informohemi e di se themelet kanë qenë të vendosura para se unë me mare unë pushtetin dhe është afër urës së Taliqit do të pyes dhe do të ju informoj për këtë çështje .

Znj. Albina Sadrija: Unë dua ta ngris një shqetësim të banorëve të disa fshatrave që udhëtojnë me autobus ku çmimi i biletës është shumë i lartë dhe në vendin ku ndalen autobusët nuk kanë as shenja të komunikacionit që janë obligim ligjor ku këto gjëra po e vështirësojnë edhe më shumë situatën ku autobusët detyrohen të ndalen në çdo vend . Kemi edhe mungesë të autobusëve në orët e hershme të mëngjesit ku nga shumica e fshatrave autobusët e parë që mbërrin në qytet janë në ora 8:00 ku po shkakton probleme për të punësuarit dhe nxënësit e shkollave .

Kryetari: Tri Grupe punuese janë krijuar menjëherë pas marrjes së Pushtetit dhe i pari ka qenë për vendosjen e stacioneve të autobusëve nëpër fshatra dhe në Qytet, i dyti ka qenë për vendosjen e njeve sanitare nëpër shkolla dhe i treti ka qenë për verifikimin e gjendjes së Qendrave të Mjekësisë Familjare, dhe i kemi raporte duhet të buxhetohen dhe nëse do ti gjemë mjete do të fillojmë në këtë vit e nëse nuk gjemë mjete do të jetë pjesë e buxhetit për vitin e ardhshëm .

z. Sadik Hoti: Fillimisht dua të ndërlidhem me pikat paraprake që nuk më lejuat që të jem pjesë e asnjërit komision dhe Komitet atë keni mundësi ta bënë por jo edhe të më largoni nga anëtari i kuvendit sepse me kanë zgjedhur qytetarët, pajtohem me znj. Diana që kryetari i komunës nuk na ka njoftuar për drejtorët e emërtuar në drejtoritë komunale. Kam një pyetje për drejtorin e DUMM-së se deri ku ka arritur plani për urbanizimin e Rugovës, një pyetje tjetër kemi për drejtorin e Inspeksionit të jenë më aktiv dhe të kontrollohen lokalet sepse po pihet duhani sepse po shkaktoj problem sidomos për fëmijët .

z. Muharrem Musa : Kërkoj që anëtarët e Kuvendit të kenë një zyre të tyre në Objektivin në Komunës, sepse kemi shumë nevojë për aktivitetet dhe punën tonë si anëtar të Kuvendit .

Kryetari: Sa i përket emrave të drejtorëve sot është shumë e lehtë që ti keni të gjitha informatat për secilin sepse e janë rrejtët sociale dhe i kanë të gjitha të dhënat , kështu që do të dalin edhe në faqen e Komunës , e dyta për Planin e Rugovës do të informohemi për këtë plan, dua të ju uroj se po fillon ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës sepse kemi arritur që të gjejmë mundësi dhe në këtë vit do të fillojnë punimet kështu që urime .

Kryesuesi: Për mbledhjen e radhës jemi duke e hartuar planin e punës së Kuvendit për këtë vit andaj ju falënderoj për kontributin tuaj dhe mirë u takofshim në takimin e radhës .

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 13:40 .

Procesmbajtës

Burim Bajrami

Kryesuesi i Kuvendit

z. Anton Shala